AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Janar 2024

16.02.2024
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin Janar 2024, viti bazë 2015=100.

Çmimet e konsumit shkuan në 1,8% vjetore dhe 0,3% mujore

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 1,8% në muajin janar 2024, krahasuar me muajin dhjetor 2023. Inflacioni mujor ishte 0,3% në muajin janar 2024.

Janar 2024 / Janar 2023 1,8%

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 1,8% në muajin janar 2024, krahasuar me muajin janar 2023. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: pemë (13,6%); peshk (9,7%); perime (9,3%); energji elektrike, gaz dhe lëndë djegëse të tjera (7,5%); mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (7,2%); sheqer, reçel, mjaltë, çokollatë dhe ëmbëlsira (7,0%); prodhime ushqimore (6,5%); ujë mineral, pije joalkoolike, lëngje nga pemët dhe perimet (6,1%); gazeta, libra dhe materiale për zyrë (5,3%); qelqurina, takëme dhe mjete të kuzhinës (5,3%); veshje (3,8%); shërbime hoteliere (2,9%); kafe, çaj dhe kakao (2,9%); duhan (2,7%); bukë dhe drithëra (2,0%); dhe mish (1,4%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2,8% në IHÇK.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal (-8,5%); vajra dhe yndyra (-7,8%); qumësht, djathë dhe vezë (-3,9%); dhe blerje e automjeteve (-2,1%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej (-1,0% në IHÇK.

Janar 2024 / Dhjetor 2023 0,3%

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0,3% në muajin janar 2024, krahasuar me muajin dhjetor 2023. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOPI-it: perime (3,7%); qumësht, djathë dhe vezë (1,3%); si dhe bukë dhe drithëra (0,9%), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,4% në IHÇK.

Rënie e çmimeve vërehet te nëngrupi: blerje e automjeteve (-1,3%), me një ndikim prej (-0,1%) në IHÇK.

Norma mujore dhe vjetore e inflacionit në % të matura nga IHÇK



Ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në % për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2024 në ‰	I - 2024 2015=100	I- 2024 XII- 2023	I - 2024 I - 2023
00	Gjithsej IHÇK	1000,0	130,2	0,3	1,8
01	Ushqimi dhe pijet joalkoolike	351,1	144,7	1,0	2,4
02	Pijet alkoolike, duhani	67,6	139,4	0,5	5,2
03	Veshje dhe këpucë	40,6	107,8	0,3	3,6
04	Strehimi , uji, energji elektrike, gazi dhe lëndë djegëse të tjera	89,8	129,3	0,2	6,4
05	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	63,0	120,9	0,0	3,1
06	Shëndetësia	22,8	116,0	-0,3	2,6
07	Transporti	176,7	121,2	-0,7	-4,5
08	Mjetet e komunikimit	23,7	114,5	0,0	-0,3
09	Rekracioni dhe kultura	44,5	106,4	0,3	5,1
10	Arsimi	6,9	104,0	0,0	-0,3
11	Restorantet dhe hotelet	40,8	129,7	0,3	3,0
12	Mallrat dhe shërbimet e ndryshme	72,2	118,8	0,2	2,3

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin janar 2024, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation